



## RAPORT NĚNTĚMUJOR I PUNÈS

DREJTORIA PĚR PUNÈ INSPEKTUESE

JANAR - SHTATOR 2023

KOMUNA E RAHOVECT

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	2
AKTIVITETE E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHIEN E OBJEKTIWAVE .....	2
STATISTIKA - GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE .....	4
PËRFUNDIM .....	4

RAPORT NENTEMUJOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

**HYRJE**

Raporti të cilin po e prezantojmë, pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese, për periudhën: janar – shtator të vitt 2023. Në këtë raport janë të përfshira punët dhe aktivitetet e kryera dhe të ndëmarrja nga Drejtoria për Punë Inspektuese të cilat janë paraqitur sipas sektorëve të cilët i mbulojmë si dikaster. Inspektimet kanë për qëllim: Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, mbrojten e interesit të përgjithshëm publik dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të subjekteve të inspektoimit.

## AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJENË OBJEKТИVATE

- Gjatë periudhës janar – shtator, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet janë realizuar në terësi duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI është organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkeseve mund të zgjasë edhe më shumë;
- Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar 940, kontolle inspektuese. Krahas prioriteteve sic janë: Parandalimi i ndërtimeve pa leje, Lirim i Hapesirave Publike, Luftimi i Ekonomisë së Zezë, Mbrojtja e Konsumatorit, prioritet dhe fokus i yni kryesor ka qenë mbrojta e shëndetit të qytetarëve;
- Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektori përkateës eshtë berë inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe ndalimi këtyre ndërtimeve deri në paisjen me leje ndërtimore, janë dëgjuar aktendime për rrënimin e ndërtimeve pa leje si posojë e mos respektimit të urdhërit për ndalim punimi, eshtë bërë mbikëqyrja e zbatimit të ligjt dhe rregullave tjera që kanë të bëjnë me ndërtimet (projektit e ndërtimit, planet etj.), mbikëqyrja e standardeve të ndërtimit dhe të produkteve ndërtimore si dhe konstrukionet që përdoren gjatë ndërtimit, janë shqiptuar edhe 75 gjoba mandatore për ndërtim pa leje;
- Të gjithë shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste u janë shpërndarë urdhëresa për tu pajisur me lejet përkësese për shfrytëzim të hapësirave publike, përkitazi me rregulloren komunale;
- Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 83 eshtë numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë;
- 83 eshtë numri i lëshuar i pëqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjenike – teknike;

- Janë kryer inspektime intensive, ku inspektorët e tregut kanë konstatuar parregullisë, poashtu kanë marrë masa në përputhje me ligjin: gjoba si dhe masa të tjera administrative;
- Janë inspektuar 158 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore, vendosjen e çmimave në produkte etj;
- Janë inspektoar edhe disa prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisa me Leje Mjedisore;
- Në fushën e transportit publik ne në vazdimësi kemi përcjellur nga afér punën e kompanive të licencuara të autobusëve, se a janë duke i mbuluar mjaftueshmë dhe sigurtë linjat e transportit të udhëtarëve, në rendet e udhëtimit të cilat janë lëshuar nga organi kompetent komunal. Poashtu, janë kryer inspektime rutinore ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve;
- Janë shqyrtuar me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve për dalje në terren kryesishët kërkesa në lidhje me çështjet komunale;
- Në bashkëpunim me DGJKP, kemi identifikuar raste të ndryshme të usurpimeve arbitrale, si dhe në koordinim me DBF, Stacionin Policor në Rahovë, është rrënuar një objekt në pronë publike në fshatin Xerxë, vlen të ceket se disa vendime janë zbatuar vullnetarisht nga uzurpatorët dhe prona publike është liruar;
- Nga USAID, kemi pranuar udhëzuesin përfundimtar dhe instrumentin për përcjelljen e protokoleve të inspektimit të ndërtimit, gjatë javëve të ardshme do te organizohen edhe trajnime për mënyrën e përdorimit të këtyj instrumenti gjatë punës së përditshme të inspektorit të ndërtimit;
- Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes së mijedisit, nga automjetet mbeturinë dhe komponentet e tyre, arrinjet përmes rrëthojave të hekurishteve, të cilat nuk duhet të kenë parme të vrashdë portëjen e integruar me mijdisin. Andaj, edhe inspektorati i komunës së Rahovecit, po përkujdeset në vazdimësi që të respektohet U.A. Nr. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve të vjetra dhe komponentet e tyre, si dhe njëkohësisht të ruhet mijdisi.

**STATISTIKA - GJABA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE**

LLOJI I INDËSHKIMIT	NUMRI I GJABAVE TË SHQIPTUARA	VLERË E GJOBËS NË €
<b>GJABA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE</b>	<b>75</b>	<b>35,365.00 €</b>
<b>GJABA MANDATORE - ÇËSHTJE KOMUANLE - GËRMIM PA LEJE, EKSPozIM I MALLRAVE USHQIMORE, SHFRYTËZIM I HAPËSIRËS PUBLIKE</b>	<b>26</b>	<b>2650€</b>
<b>GJABA MANDATORE PËR MUNGESË DOKUMENTACIONI, MOSPËRPUTHJE ÇMIMESH</b>	<b>7</b>	<b>350€</b>
<b>GJABA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS</b>	<b>12</b>	<b>600 €</b>
<b>GJABA MANDATORE PËR MIEDIS</b>	<b>33</b>	<b>1260 €</b>
<b>TOTALI:</b>	<b>153</b>	<b>43,375€</b>

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERË NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	33	310€
PËLQIME PUNE	83	1245€
<b>TOTALI:</b>	<b>116</b>	<b>1555 €</b>

**TOTAL TË HYRA PËR KËTË PERIUDHË RAPORTUESE: 44,930€**

**PËRFUNDIM**

*Përkundëri të gjitha sfidave, konsiderojmë që jemi në rrugë të mirë për përbushjen e të gjitha objektivave, sigurisht edhe me një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat po na ndihmojnë me arritjen e rezultateve konkrete.*

## RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

[ 5 ]

Nora BOSHNAKU

Drejtoreshë për Punë Inspektuese